



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDER KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TE ORGANIZUAR

Nr. 285/Prot./M.K.

Tiranë, më 15.04, 2021

Lënda: *Përcillet për kompetencë materiali kallëzues*

Drejtuar: PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TIRANË

Për dijani : PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË
TIRANË

Me shkresën nr. 53 prot datë 07.04.2021 është depozituar një kallëzim penal nga subjekti Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. G.Bardhi, me pretendimin se është konsumuar vepra penale e “Shpërdorimit të detyrës”, dhe “Korrupsion aktiv në zgjedhje” parashikuar nga nenet 248, 328 të Kodit Penal.

Pas studimit të hollësishëm të kallëzimit rezulton se nuk ka të dhëna për veprën penale të “Korrupsionit aktiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328 të Kodit Penal. Në tërësinë e kallëzimit pretendohet për veprime në kundërshtim me ligjin të një subjekti drejtoreshë shkolle, pra që ushtron detyrë shtetërore dhe që dyshohet se përdor funksionin e saj për motive politike apo merr pjesë në fushatë për një subjekt të caktuar politik, veprime këto që mund të kualifikohen në kuadër të veprave penale “Shpërdorimit të detyrës”, dhe “Përdorim të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” të parashikuar nga nenet 248 dhe 328/a të Kodit Penal.

Ndodhur në këto kushte pamvarësisht pretendimit të kallëzuesit se cilat vepra penale janë kryer, konstatohet që materiali referon për vepra penale që nuk janë në kompetencë të Prokurorisë tonë referuar nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, apo subjekte të Posaçëm referuar nenit 3 të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Për këtë arsye ju përcjellim materialin kallëzues për vlerësim nga ana juaj.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTUESI I PROKURORISË

Arben KRAJA

